



**Prof. dr. Begzad Baliu**

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Edukimit

Prishtinë, Bregu i diellit, Rruga “Gazmend Zajmi”, B1, H1, nr. 23

Tel. +377 (0)44 173 596

E-mail: [bbaliu@yahoo.com](mailto:bbaliu@yahoo.com), [begzad.baliu@uni-pr.edu](mailto:begzad.baliu@uni-pr.edu)

I lindur në Makresh të Gjilanit, më 1966. Është filolog, publicist, shkrimtar dhe editor. Profesor i rregullt (ordinar) në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit.

Autor i shumë veprave studimore nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, historisë dhe kulturës shqiptare.

Ligjërues dhe kumtues në disa universitete, konferenca shkencore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, si në Universitetin e Turunit “Nikolla Koperniku”, Universitetin e Shkupit, Universitetin e Varshavës, Universitetin e Europës Juglindore (Budapest) etj. Organizator dhe koordinatar i shumë konferencave me karakter ndërkombëtar, pothuajse në të gjitha universitetet dhe institutet shkencore shqiptare në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe në Mal të Zi: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë, Gjirokastër, Ulqin, Tetovë etj.

Ishte kryeredaktor i revistës shkencore “Shenjëzat” dhe “Educologia” ( Prishtinë); anëtar i redaksisë së revistës ndërkombëtare “Malësia” (Podgoricë); anëtar i redaksisë së kolanës universitare “Sociolinguistika shqiptare” (Korçë); mentor dhe bashkëmentor i disa projekteve, si ai i Universitetit të Varshavës me temë “Kosova e pavarur në sytë e të rinjve të saj (shoqëria - kultura – politika)”, anëtar i projekteve: “Bibliografia universale e Nënës Tereze” (Tiranë, 2015- ); anëtar i projektit “Eposi në pesë shtete të Ballkanit” dhe bartës i nënprojektit të tij “Eposi në

ndërdijen kombëtare”, i cili mori çmimin special *Europa Nostra*, nga Këshilli Evropian), drejtues i projektit *Gjuha e teksteve të historisë në Kosovë* (Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti Indiana, SHBA), anëtar i projektit *Struktura letrare dhe didaktike e Librit të leximit në Kosovë* (Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Lubjanës), ndërsa në vitin 2008 ishte i nominuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë për Çmimin e Vitit, me veprën *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*; Ambasador i Paqes nga viti 2009.

Vepra e tij është recensuar dhe vlerësuar nga studiues, si: Prof. Jup Kastrati, Prof. dr. David Luka, Akademik Gjovalin Shkurtaj, Prof. Shefki Sejdiu, Prof. dr. Petrit Kotri, Prof. dr. Rami Memushaj, dr. L’ubor Kralik, Prof. dr. Rexhep Doçi, Prof. dr. Shaban Sinani, Prof. dr. Zymer Neziri, Prof. dr. Tefë Topalli, Prof. dr. Zenun Gjocaj, Prof. Mentor Quku, dr. Ledi Shamku, Prof. dr. Bahtijar Kryeziu, dr. Musa Ahmeti, Prof. dr. Jusuf Osmani, Prof. dr. Mustafa Ibrahim, Prof. dr. Merxhan Avdyli, Prof. Avdyl Sulaj, Prof. dr. Zhyljeta Kadilli etj.

Nga vitit 2009 konceptet e tij për *Historinë e albanologjisë* janë përfshirë në Syllabusin e studimeve master të Universitetit të Vlorës, ndërsa vepra *Kërkime albanologjike* si vepër obliguese. Gjithashtu në veprën universitare *Onomastika shqiptare*, puna kërkimore e Begzad Baliut në këtë fushë është përfshirë në një kapitull të veçantë. Gjithashtu, disa nga studimet e tij shkencore gjuhësore dhe veprat letrare e publicistike janë botuar në gjuhën angleze, italiane, holandeze, boshnjake, kroate dhe rumune.

Tri dekadat e fundit i është besuar përgatitja e veprave studimore të Eqrem Çabejt, Jup Kastratit, Shefki Sejdiut, Zenun Gjocajt, Nuhi Veselajt etj.

## **Vepra të botuara:**

### **I. Në fushë të albanologjisë**

- *Gustav Majer dhe albanologjia*, Prishtinë, 2000; Tiranë, 2001
- *Vepra bibliografike e profesor Jup Kastratit*, Prishtinë, 2005
- *Semantika e fjalësit (Vepra albanologjike e Zenun Gjocajt)*, Prishtinë, 2009
- *Kërkime albanologjike*, Prishtinë, 2010
- *Referenca albanologjike*, Prishtinë, 2010
- *Hulumtime albanologjike*, Prishtinë, 2015
- *Testamenti shkencor i Profesor Jup Kastratit*, Prishtinë, 2016
- *Lisi i madh – Akademik Idriz Ajeti (bashk.)*, Prishtinë, 2016 (në shtyp)
- *Sprovë për një histori të albanologjisë*, Prishtinë, 2016

## II. Në fushë të onomastikës dhe të leksikografisë

- *Onomastika e Gallapit, (I)*, Prishtinë, 2016
- *Onomastika dhe dokumenti*, Prishtinë, 2016
- *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, Prishtinë, 2014
- *Onomastikë dhe identitet*, Prishtinë, 2012.
- *Onomastika e Kosovës - ndërmjet miteve dhe identiteteve*, Prishtinë, 2009
- *Regjistri i standardizuar i emërvendeve të Kosovës (bashk.)*, Prishtinë, 2005
- *Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës*, Prishtinë, 2006
- *Kontributi i Eqrem Çabejt në fushë të onomastikës*, Prishtinë, 2000

## III. Në fushë të bibliografisë

- *Çabej I*, Prishtinë, 2006.
- *Bibliografia përmbajtjesore e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 2008
- *Mbi autorësinë e veprës “Bibliografia e Skënderbeut”*, Prishtinë, 2005

## IV. Në fushë të studimit të letërsisë dhe të krijimtarisë letrare

- *Struktura e vlerave përfaqësuese*, Prishtinë, 2014
- *Kujtesa letrare*, Prishtinë, 2013,
- *Pesha e komunikimit (bashk.)*, Prishtinë, 2010
- *‘Dhembje e bukur’*, (bashk.), Prishtinë, 2012
- *Vareni kryengritësin e shenjtëruar*, Prishtinë, 2010
- *Kafeneja ballkanike*, Prishtinë, 1996 (e përkthyer edhe në kroatisht, italisht dhe holandisht)
- *Grua e dashuruar*, Prishtinë, 1996

## V. Përgatiti për botim veprat

- *Rëndësia e veprës së Gustav Majerit për studimet albanologjike*, Sesion shkencor kushtuar 100-vjetorit të botimit të këngës kreshnike shqiptare, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998. (bashk.)
- *Eqrem Çabej – Jeta dhe vepra* (Sesioni kushtuar 90-vjetorit të lindjes së Eqrem Çabejt, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003 (bashk.)
- Eqrem Çabej, *Studime për onomastikën historike të shqipes*, (në proces), Tiranë, 2016

- Jup Kastrati, *Bibliografia e Prof. dr. Eqrem Çabejt*, (Përkujdesja dhe parathënia e Begzad Baliut), Prishtinë, 2003.
- Jup Kastrati, *Bibliografi albanistike*, I, (Përkujdesja dhe parathënia e Begzad Baliut), Prishtinë, 2003.
- Jup Kastrati, *Jup Kastrati për Kosovën (bashk.)*, Prishtinë, 2004
- Jeta e re. Revistë letrare. Numër i veçantë kushtuar 90-vjetorit të lindjes së Eqrem Çabejt (1908-1998), nr. 4, Prishtinë, 1998. (bashk.)
- Jup Kastrati, *Figura të ndrituna të Rilindjes Kombëtare I*, (Botim anastatik me Parathënie të Begzad Baliut), Prishtinë, 2003.
- Shefki Sejdiu, *Sprova etimologjike*, (përkujdesja dhe parathënia e mr. Begzad Baliut), Prishtinë, 2002.
- Shefki Sejdiu, *Struktura, sisteme, raporte*, (përkujdesja dhe parathënia e mr. Begzad Baliut), Prishtinë, 2002.
- Shefki Sejdiu, *(Iliro-arbroro)shqiptarët dhe gjuha e tyre në Universin globalist*, (përkujdesja, parathënia dhe pasthënia e prof. dr. Begzad Baliut), Prishtinë, 2016.

Jeton në Prishtinë. Tel. +377 (0)44 173 596

E-mail: [bbaliu@yahoo.com](mailto:bbaliu@yahoo.com), [begzad.baliu@uni-pr.edu](mailto:begzad.baliu@uni-pr.edu)